



REPUBLIKA E KOSOVËS \* REPUBLIKA KOSOVA  
KOSOVA CUMHURIYETI  
Komuna e Prizrenit \* Opština Prizren  
Prizren Belediyesi  
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine  
Belediye Başkanı

01 Nr. 156/26 Dt. 08.04.2026



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës 01-030 nr. 27683 datë 06.03.2026 të Qëndrim Hoxhës, kryetari i Komunës, merr këtë:

### V E N D I M Për lejimin e mjeteve financiare

1. Miratohet kërkesa 01-030 nr. 27683 datë 06.03.2026 e Qëndrim Hoxhës, drejtor i Ekzekutiv, Shoqata për Zhvillimin e Lidershipit në Kosovë/Leadership Development Association in Kosova, për lejimin e mjeteve financiare për mbështetje në organizimin e Konferencave “DREAMin dhe LEAPin Conference 2026”, që planifikohet të mbahet 18 prill 2026 në ITP Prizren, kështu që, për këtë qëllim, dhe në emër të mbulimit të shpenzimeve të këtij aktiviteti (sigurimi i hapësirës (sallës) për mbajtjen e konferencës, akomodimit, ushqimit dhe pijeve, etj.), lejohen mjetet e nevojshme financiare.
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.
3. Obligohet Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës  
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
  - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
  - Të lartcekurit
  - Arkivës së Kryetarit.